



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRI

Nr. 4100 Prot.

Tiranë 13.08.2013

U D H Ë Z I M
Nr. 37, datë 13.08.2013

**“PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE
TË KËSHILLIT VENDOR TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin e arsimit parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU 1

KËSHILLI VENDOR I ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

1. Këshilli vendor i arsimit parauniversitar është organ këshillimor, në nivel qarku, për politikat e zhvillimit të arsimit parauniversitar, brenda juridiksionit territorial të qarkut.
2. Këshilli vendor i arsimit parauniversitar, më tutje “KVA”, jep mendime:
 - a) për hartimin e strategjive dhe programeve arsimore vendore;
 - b) për aspekte të zhvillimeve arsimore në nivel qarku, bashkie e komune, që janë nën përgjegjësinë e tyre;
 - c) për bashkëpunimin me njësitë arsimore vendore përkatëse (Drejtoria Arsimore Rajonale/Zyra Arsimore) (DAR/ZA);
 - d) për çështje të tjera të politikave arsimore, me kërkesën e kryetarit dhe anëtarëve të KVA-së.
3. KVA krijohet me vendim të kryetarit të këshillit të qarkut dhe funksionon sipas rregullores së miratuar prej tij.
4. KVA kryesohet nga kryetari i këshillit të qarkut dhe ka në përbërje:
 - a) përfaqësues nga njësitë bazë të qeverisjes vendore përkatëse,
 - b) përfaqësues nga njësitë përkatëse arsimore vendore,
 - c) personalitete të njohura për kontribute në jetën publike të qarkut.
5. Numri i përgjithshëm i anëtarëve të KVA-së dhe i personaliteteve për kontribute në jetën publike vendoset nga këshilli i qarkut, duke qenë jo më shumë se 13 vetë.

KREU 2

KRITERET DHE PROCEDURAT

1. Pjesëmarrja në KVA organizohet sipas këtyre kriterëve:
 - a) Një përfaqësues nga çdo bashki.
 - b) Nga një përfaqësues në dy komunat me numrin më të madh të nxënësve në institucionet arsimore në juridiksion (kopsht, shkolla).
 - c) Një përfaqësues nga DAR-ja dhe çdo ZA
2. Procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të KVA-së janë si më poshtë:
 - a) Nga bashkia dhe komuna e përzgjedhur është anëtar kryetari saj ose një punonjës i caktuar prej tij.
 - b) Nga DAR-ja dhe ZA-të marrin pjesë titullarët e tyre.
3. Anëtarët e KVA-së, të cilët janë personalitete të njohura për kontribute në jetën publike të qarkut:
 - a) i nënshtrohen konkurrimit publik;
 - b) përzgjidhen nga një komision, i ngritur pranë kryetarit të qarkut, i përbërë nga një përfaqësues i qarkut, një përfaqësues i bashkisë më të madhe dhe një përfaqësues i DAR-së.

KREU 3


RREGULLORJA E KVA-së

1. Rregullorja e KVA-së, përshkruan veprimtarinë e tij dhe miratohet në mbledhjen e parë të saj.
2. Rregullorja bazohet në rregulloren e Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar dhe përshtatet në kushtet specifike të qarkut.

Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi: Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoritë Arsimore Rajonale/Zyrat Arsimore.

Ky Udhëzim hyn në fuqi pasi botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI


MYQEREM TAFAJ

